

VENDIM
Nr. 934, datë 28.12.2016

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA POLIÇAN,
TË PRONËS NR.1072, ME EMËRTIM “KOMBINATI MEKANIK, UZINA NR.1”, ME
VENDNDODHJE NË POLIÇAN, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515,
DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR,
DHE NË VENDIMIN NR.207, DATË 9.3.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIMTË BASHKISË
POLIÇAN, TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Poliçan, të pronës nr.1072, me emërtim “Kombinati Mekanik, Uzina Nr.1”, me vendndodhje në Poliçan, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi, për ta përdorur për nevoja administrative, për realizimin e funksioneve ekonomike, social-kulturore, për grumbullimin e produkteve bujqësore e blegtorale dhe për kryerjen e funksioneve të tjera, sipas ligjit.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr.1072, me emërtim “Kombinati Mekanik, Uzina Nr.1”, me vendndodhje në Poliçan, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Poliçan, miratuar me vendimin nr. 207, datë 9.3.2011, të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë Poliçan i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Poliçan, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANVENDOSJA E

Pronës nr. 1072 "Kom. Mekanik Uzina nr.1" Poliçan

Sistemi i Koordinatave Shqiptare

MIRATOHET
Drejtori i kombinatit Mekanik
Në mungesë
K/Inxh. ARDIAN SPAHO


(Signature)



SHËNJESE

Sip. e përgjithshme ~80 608m²
Sip. nën Objekt = 1773,72m²
Sip. e tuneleve = 9800m²

— Kufiri i uzinës nr.1



Shënim : Kjo planvendosje u hartua në zbatim të shkresës së Shëfit të Shtabit të Përgjithshëm të FA nr.9585/1 datë 10.10.2016 dhe mbi bazën e dokumentacionit hartografik të marrë në arkivi e IGJRU

Rihartuar Tetor 2016

